



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1263

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) AGRI BAU SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit-Negociuar me numër të prokurimit 616-25-11111-2-2-5, me 20.02.2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet pjesërishtë ankesa e OE AGRI BAU SH.P.K. me nr. 2025/1263, e datës 23.12.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit”-Negociuar me numër të prokurimit 616-25-11111-2-2-5.
2. Mbetet në fuqi, kontrata e nënshkruar nga AK- Kuvendi i Komunës së Prishtinës, procedura emergjente sikurse parashihet në nenin 35.2 (iii) të LPP-së , lidhur me aktivitetin e prokurimit sipas dispozitivit I të këtij vendimi.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërishte e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.12.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Ftesën për ofertim, për aktivitetin e prokurimit Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit-Negociuar me numër të prokurimit 616-25-11111-2-2-5.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të negocuar, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 100,000.00 €.

Me 12.12.2025 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE TE FATOSI SH.P.K.

Me 16.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.12.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 23.12.2025, OE AGRI BAU SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1263, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues AGRI BAU SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi Ankimor 1

Autoriteti Kontraktues ka iniciuar dhe përmbyllur një procedurë të negocuar pa publikim të njoftimit për kontratë për të njëjtën lëndë prokurimi, ndërkohë që procedura e hapur ishte ende aktive dhe nuk ishte përfunduar me vendim përfundimtar. Ky veprim është kryer pa njoftuar dhe pa ftuar Grupin e Operatorëve Ekonomikë AGRI BAU SH.P.K. dhe ANEA GROUP SH.P.K., të cilët janë palë me interes të ligjshëm dhe kanë kapacitet të provuar teknik, profesional dhe ekonomik.

Zhvillimi i procedurës së negocuar pa publikim në këto rrethana bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, transparencës dhe konkurrencës efektive, duke përbërë shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 1, 6 dhe 7 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Procedura e negocuar pa publikim përbën përjashtim nga rregulli dhe lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, të cilat duhet të dokumentohen dhe arsyetohen qartë nga Autoriteti Kontraktues. Në këtë rast, AK nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të justifikojë urgjencë ekstreme apo pamundësi për përfundimin e procedurës së hapur.

Përjashtimi i Ankuesit nga procedura ka kufizuar konkurrencën dhe ka favorizuar operatorin ekonomik të caktuar “TE FATOSI” SH.P.K., i cili paraprakisht kishte ofruar një çmim më të lartë në procedurën e hapur, duke e shndërruar procedurën e negocuar në një instrument të paracaktuar dhe të paligjshëm.

Ky veprim i AK-së, duke filluar procedurën e negociuar pa publikim gjatë kohës që procedura e hapur ishte objekt rishqyrtimi/ankese, tregon qartë qëllimin për të shmangur efektet juridike të kërkesës për rishqyrtim dhe për të anashkaluar kontrollin e OSHP-së. Si rrjedhojë, procedura e negociuar pa publikim duhet të konsiderohet e paligjshme në tërësi, vendimi për dhënie të kontratës i pavlefshëm nga aspekti procedural, ndërsa kontrata e lidhur juridikisht e kontestueshme dhe e anulueshme.

1. Neni 1 i LPP-së dhe neni 50.8 i Rregullores së Prokurimit Publik

Neni 1 i Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) përcakton se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë shfrytëzim sa më efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike. Veprimet e Autoritetit Kontraktues (AK), duke na përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurën e negociuar dhe duke ftuar operatorë të tjerë të ndikuar nga fituesi i kontratës, kanë penguar konkurrencën reale.

Kjo ka çuar në rrezikimin e përdorimit efikas të fondeve publike, pasi kontrata ka mundur të lidhej me operatorin më të favorshëm ekonomikisht dhe me kapacitete të dëshmuara për përfundimin e aktivitetit. Duke favorizuar OE “TE FATOSI” SH.P.K., fondet publike nuk janë shfrytëzuar në mënyrë optimale, duke cenuar objektivat themelore të Nenit 1 të LPP-së.

Në mënyrë më të gjerë, procedura e negociuar pa publikim, e zhvilluar ndërkohë që procedura e hapur ishte ende aktive, tregon qartë keqpërdorim sistematik të kompetencave të AK-së. Duke përjashtuar operatorët ekonomikë që kanë interes të ligjshëm dhe duke ftuar formalisht klientë të OE fitues, AK ka eliminuar konkurrencën reale, duke çuar në vendimmarrje joefikase dhe në rrezikim të fondeve publike, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Nenin 1 të LPP-së.

Ky model veprimi demonstroi se qëllimi i procedurës nuk ka qenë realizimi i shfrytëzimit efikas të parasë publike, por favorizimi i operatorëve të caktuar. Për rrjedhojë, të gjitha vendimet e marra nga AK, përfshirë vendimin për dhënie të kontratës dhe përjashtimin tonë nga negociatat, duhet të vlerësohen si të pavlefshme nga aspekti procedural dhe si shkelje e qartë e Nenit 1 të LPP-së.

Neni 50, paragrafi 8 i Rregullores së Prokurimit Publik

Sipas nenit 50.8 të Rregullores së Prokurimit Publik, Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të sigurojë negociatat me një numër të mjaftueshëm operatorësh ekonomikë për të garantuar konkurrencë efektive, si dhe të sigurohet që procesi të jetë transparent dhe të dokumentohet saktë në të gjitha fazat për të ruajtur integritetin e tij.

Në këtë rast, fakti që AK ka ftuar vetëm njërin nga ofertuesit e procedurës së hapur, duke mos na ftuar neve si ofertues me ofertën më të mirë të ofruar, por duke manipuluar procesin me operatorë ekonomikë të cilët as që kishin marrë pjesë në procedurën e hapur (klientë të operatorit ekonomik “TE FATOSI” SH.P.K.), përbën shkelje substanciale të këtij neni dhe ngre shqetësime serioze lidhur me garantimin e konkurrencës dhe transparencës së procesit.

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi

Në cilësinë e palës së interesuar, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim duke argumentuar se mosdërgimi i ftesës për pjesëmarrje në procedurën e negociuar përbën shkelje të rëndë të Parimit të Barazisë dhe trajtim diskriminues ndaj nesh.

Ky veprim bie ndesh me parimin e barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), i cili kërkon që autoriteti kontraktues të trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe të veprojë në mënyrë transparente. AK ka kryer një veprim kundërligjor dhe jo transparent përmes procedurës së negociuar. Ne jemi palë e interesit dhe kemi pësuar dëm të qartë ekonomik dhe procedural për shkak të mosftesës në negociata.

Sqarim i Pretendimit Ankimor (skemë e keqpërdorimit të procedurës së negociuar)

Nga veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues (AK) rezulton qartë se nuk kemi të bëjmë me një situatë të jashtëzakonshme apo të ligjshme për aplikimin e procedurës së negociuar, por me një skemë të ndërtuar qëllimisht për keqpërdorimin e kësaj procedure, përmes krijimit artificial të kushteve që çojnë në eliminimin e konkurrencës reale.

Kjo skemë manifestohet në disa hapa të ndërlidhur dhe të qëllimshëm. Fillimisht, Ankuesi ose pala që synohet të përjashtohet nga dhënia e kontratës rekomandohet për dhënie të kontratës, bazuar në vlerësimin e ligjshëm të ofertave dhe në përmbushjen e kriterëve, duke përfshirë çmimin më të ulët të vlerësuar.

Më pas, ky rekomandim ndryshohet përmes një procesi formal të ashtuquajtur “rivlerësim”, i iniciuar pas një kërkesë për rishqyrtim nga një operator tjetër ekonomik (në të gjitha rastet është fituesi i kontratës), kërkesë e cila ka shërbyer vetëm si instrument procedural dhe jo si mjet real juridik për korrigjimin e ndonjë shkeljeje.

Në vijim, pas këtij ndryshimi të qëllimshëm të vendimit, AK inicion procedurë të negociuar, duke u thirrur në rrethana të krijuara artificialisht nga vetë veprimet e tij paraprake. Në këtë fazë, përmes një keqinterpretimi të qëllimshëm të nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së, AK e përjashton Ankuesin dhe operatorë të tjerë ekonomikë nga statusi i “Palës së Interesit”, duke pamundësuar pjesëmarrjen e tyre në procedurën e negociuar.

Si rezultat, pjesëmarrja në procedurë kufizohet vetëm në operatorët ekonomikë të ftuar formalisht nga AK, ndërsa konkurrenca reale eliminohet plotësisht. Në këtë mënyrë, fituesi i kontratës bëhet i paracaktuar, çka bie ndesh drejtpërdrejt me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë, të parashikuara në LPP.

Kjo mënyrë veprimi dëshmon se AK nuk ka vepruar në ushtrim të ligjshëm të kompetencave të tij, por ka ndërtuar një mekanizëm procedural të qëllimshëm, ku:

- Rekomandimi fillestar për kontratë shërben si fazë formale;
- Ndryshimi i vendimit pas kërkesës për rishqyrtim përdoret si mjet për krijimin e kontestit;
- Ndërsa procedura e negociuar shfrytëzohet si instrument për lidhjen e kontratës në mënyrë jo transparente dhe pa konkurrencë reale.

Për rrjedhojë, pretendimi ankimor nuk ka të bëjë vetëm me shkelje të izoluara procedurale, por me keqpërdorim sistematik të dispozitave të LPP-së, me qëllim të shmangies së procedurave të hapura dhe të favorizimit të një operatori të caktuar ekonomik.

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e dhënë ndaj Kërkesës sonë për Rishqyrtim, është mbështetur plotësisht në keqinterpretimin skandaloz dhe të qëllimshëm të nenit 4, paragrafi 1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky keqinterpretim është përdorur si bazë e vetme për të mohuar statusin tonë si “Palë e Interesit” dhe, rrjedhimisht, për të justifikuar përjashtimin tonë nga procedura e negociuar.

Megjithatë, ajo që e bën edhe më të rëndë këtë shkelje është fakti se ky veprim nuk përbën një rast të izoluar apo një gabim interpretimi në këtë procedurë konkrete. Përkundrazi, ekzistenca e një skeme të ndërtuar dhe të përdorur sistematikisht nga AK-ja vërtetohet nga fakti se përgjigja ndaj Kërkesës sonë për Rishqyrtim e datës 18.12.2025 është në thelb “copy-paste” i një përgjigjeje të mëparshme, të dhënë për të njëjtën çështje juridike ndaj një operatori tjetër ekonomik, në një procedurë tjetër prokurimi, po ashtu të zhvilluar përmes procedurës së negociuar (shih përmbajtjen e vendimit në Kërkesën për Rishqyrtim bashkangjitur).

Vendimi mbi Kërkesë për Rishqyrtim, ku është hedhur poshtë si e palejuar, sipas dokumentit të dërguar përmes E-prokurimit, nuk ka datë të saktë se kur është marrë ky vendim, por vetëm se me datë 18.12.2025 është ngarkuar në sistemin E-prokurimi.

Kjo dëshmon se Komuna, përkatësisht AK, përdor në mënyrë të përsëritur dhe të qëllimshme të njëjtin keqinterpretim të nenit 4.1.26 të LPP-së si instrument për të:

- përjashtuar operatorët ekonomikë që realisht janë palë të interesit;
- kufizuar pjesëmarrjen vetëm tek operatorët e ftuar formalisht;
- dhe për të legjitimuar, në mënyrë artificiale, aplikimin e procedurës së negociuar.

Përdorimi i një përgjigjeje standarde, identike në përmbajtje, pa analizë individuale të rrethanave faktike dhe juridike të secilës procedurë, përbën shkelje të rëndë të detyrimit të AK-së për trajtim të drejtë, objektiv dhe të arsyetuar të kërkesave për rishqyrtim. Një veprim i tillë dëshmon mungesë të vlerësimit real juridik dhe konfirmon ekzistencën e një praktike të konsoliduar të keqpërdorimit të procedurave të negociuara.

Interpretimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP-së është jo vetëm i gabuar, por edhe logjikisht i paqëndrueshëm dhe juridikisht i papranueshëm.

Në këtë kontekst, shtrohet një pyetje legjitime dhe thelbësore:

Si mund të bëhet Ankuesi, apo cilido operator tjetër ekonomik, “Palë e Interesit” në një procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, nëse interpretimi i AK-së do të ishte i saktë?

Në procedurat e negociuara pa publikim, operatorët ekonomikë nuk kanë asnjë mundësi objektive për të shprehur interes, për të paraqitur kërkesë për pjesëmarrje apo për të konkurruar, përveç rasteve kur ftohen drejtpërdrejt nga vetë AK-ja.

Nëse statusi i “Palës së Interesit” do të kufizohej vetëm tek operatorët e ftuar nga AK-ja, atëherë kjo do të nënkuptonte se:

- asnjë operator tjetër ekonomik nuk do të mund të fitojë kurrë statusin e palës së interesit;

- e drejta për ankesë dhe mjete juridike efektive do të bëhej iluzore;
- dhe AK do të kishte kompetencë absolute për të përjashtuar çdo operator ekonomik nga mbrojtja ligjore, thjesht duke mos e ftuar në procedurë.

Një interpretim i tillë është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me qëllimin e LPP-së, me parimet themelore të transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, si dhe me vetë konceptin e mjeteve juridike efektive në prokurimin publik.

Për më tepër, një interpretim i tillë do të krijonte hapësirë të pakufizuar për abuzim, duke e shndërruar procedurën e negociuar pa publikim në një instrument përjashtues dhe të pakontrollueshëm.

Prandaj, neni 4.1.26 i LPP-së duhet të interpretohet në mënyrë funksionale, duke përfshirë si “Palës së Interesit” edhe operatorët ekonomikë që kanë marrë pjesë në procedurat paraprake për të njëjtën lëndë prokurimi, veçanërisht ata që kanë pësuar dëm real ose potencial nga veprimet e AK-së.

Çdo interpretim tjetër jo vetëm që bie ndesh me ligjin, por edhe e zhvesh sistemin e prokurimit publik nga garancitë minimale të mbrojtjes juridike.

Ankuesi vlerëson se çështja juridike e ngritur në këtë ankesë ka qenë tashmë objekt shqyrtimi nga OSHP-ja në raste të mëparshme, në rrethana faktike dhe juridike të krahasueshme. Në këtë drejtim, OSHP ka dhënë gjykim të drejtë lidhur me statusin e “Palës së Interesit” dhe zbatimin e nenit 4, paragrafi 1.26 të Ligjit për Prokurimin Publik në kontekstin e procedurave të negociuara pa publikim, përfshirë, ndër të tjera, vendimin (dhe jo vetëm) e OSHP-së me nr. 2025/0228, të datës 22.05.2025, me numër të prokurimit 214-25-1102-2-1-5.

Në këtë kuptim, Ankuesi kërkon që OSHP-ja, duke u mbështetur në interpretimet e dhëna në vendimin e sipërpërmendur, të veprojë në mënyrë të njëjtë edhe në këtë rast konkret. Një qasje e tillë do të siguronte zbatim të barabartë dhe të qëndrueshëm të ligjit, si dhe do të kontribuonte në ndërprerjen përfundimtare të praktikave abuzuese të Autoritetit Kontraktues, të cilat bazohen në keqinterpretimin e nenit 4.1.26 të LPP-së.

Një vendim i tillë nga OSHP-ja do të kishte jo vetëm efekt korrigjues për këtë procedurë konkrete, por edhe efekt parandalues për raste të ardhshme, duke garantuar respektimin e parimeve themelore të prokurimit publik dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të operatorëve ekonomikë.

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se procedura e negociuar është zhvilluar në përputhje me nenin 50, paragrafi 8 të RRPP-së, si dhe pohimi se mosftesa e Ankuesit në procedurë nuk përbën shkelje ligjore, mbështetet drejtpërdrejt në keqinterpretimin e nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së.

AK, përmes këtij keqinterpretimi, e kufizon nocionin e “Palës së Interesit” vetëm tek operatorët ekonomikë të ftuar në procedurën e negociuar, duke përjashtuar operatorë të tjerë që kanë interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm, përfshirë Ankuesin.

Një interpretim i tillë është juridikisht i papranueshëm, pasi neni 4.1.26 i LPP-së nuk e lidh statusin e palës së interesit me faktin e ftesës nga AK-ja, por me ekzistencën e një interesi real ose potencial dhe me mundësinë e pësimit të dëmit nga veprimet e AK-së.

Në këtë kuptim, neni 50.8 i RRPP-së nuk mund të interpretohet i shkëputur nga neni 4.1.26 i LPP-së. Përkundrazi, këto dy dispozita duhet të lexohen dhe zbatohen në mënyrë të ndërlidhur.

Detyrimi i AK-së për të negociuar me një numër të mjaftueshëm operatorësh ekonomikë për të siguruar konkurrencë efektive presupozon domosdoshmërisht njohjen dhe përfshirjen e të gjithë operatorëve që janë “Palë e Interesit”, e jo vetëm të atyre që AK zgjedh t’i ftojë.

Argument shtesë – Interpretimi i KRPP-së, 11.12.2022

A ka të drejtë OE të parashtrojë kërkesë për rishqyrtim/ankesë në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor, si në vijim:

Paragrafi 1 i nenit 108/A të LPP-së përcakton:

“1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.”

Në kuptim të paragrafit 1 të nenit 108/A të LPP-së, pavarësisht procedurës që është përdorur, çdo “palë e interesuar”, siç përkufizohet në nenin 4, nënparagrafi 1.26 të LPP-së, e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti prokurimi dhe e cila është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues.

Si rrjedhojë, edhe në rastin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë, një OE mund të parashtrojë një kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-së, nëse të njëjtin AK ka mundur ta ftojë që të dorëzojë ofertë, por nuk e ka ftuar.

Pra, e drejta në kërkesë për rishqyrtim/ankesë e çdo pale të interesuar është e garantuar me ligj. Megjithatë, në rastin e procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit për kontratë, siç përcaktohen rastet e emergjencave ekstreme me nenin 35.2.1 (iii) të LPP-së, AK mund të nënshkruajë kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave, sepse ky kusht përjashtohet me nenin 26, paragrafi 4, nënparagrafi 4.1 i LPP-së.

Si rrjedhojë, efekti i pezullimit nuk vlen vetëm në rastet e emergjencave ekstreme siç përcaktohen me nenin 35.2.1 (iii) të LPP-së, si në vijim, citat:

“(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme, të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj. Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t’u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të

autoritetit kontraktues.”

Në raste të tjera (jo emergjente ekstreme) të procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë, AK nuk mund të nënshkruajë kontratën pa kaluar periudhat kohore të ankesave.

Prandaj, duke u bazuar edhe në interpretimin e KRPP-së të lartcekur, pretendimi i AK-së se procedura është zhvilluar në përputhje me nenin 50.8 të RRPP-së është i pabazuar.

Po ashtu, AK nuk na ka dhënë qasje në dokumentet zyrtare, edhe pse kërkesën për qasje në dokumente zyrtare e kemi bërë me datë 18.12.2025 përmes platformës E-prokurimi, si dhe përmes tre (3) email-eve zyrtare të prokurimit, mirëpo nuk ka pasur asnjë reagim nga ana e AK-së.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori ekonomik “Agri Bau” Sh.P.K. (tutje: parashtruesi), me datë 16.12.2025, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale”, me nr. të prokurimit 616-25-1179-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim është konstatuar se parashtruesi nuk ka dorëzuar fare ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe, rrjedhimisht, nuk është pjesë e këtij aktiviteti të prokurimit. Ky fakt nuk kontestohet as nga vetë parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë mënyrë, është gjetur se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 26 të LPP-së, ku përcaktohet se:

“Palë e interesuar është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi, duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar.”

Po ashtu, përmes nenit 59, paragrafi 1 të RRPP-së është përcaktuar se:

“Kërkesa për rishqyrtim mund të dorëzohet, pa pagesë, nga cilado palë e interesuar...”

Në këtë mënyrë, është gjetur se nuk janë përmbushur kushtet për të parashtruar kërkesën për rishqyrtim në kuptim të nenit 59, paragrafi 1 të RRPP-së, për shkak se parashtruesi nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 26 të LPP-së.

Nga sa u tha më sipër, është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 1 të RRPP-së, lidhur me nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 26 të LPP-së.

Përtej faktit që parashtruesi është palë pa interes, duhet theksuar se përmes nenit 35, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, pika (iii) të LPP-së, përcaktohet si në vijim:

“Neni 35 – Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës

Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës për të ushtruar aktivitetin e prokurimit vetëm pasi që të jetë në pajtim me këtë nen. KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë brenda dy ditëve nga data kur

vendimi për përdorimin e procedurave të tilla është marrë. Autoriteti kontraktues duhet që në njoftim të ofrojë një shpjegim të hollësishëm të fakteve të konsideruara dhe justifikimin për përdorimin e procedurës.

Autoriteti kontraktues mund të përdorë procedura të negociuara pa publikimin paraprak të njoftimit të kontratës për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e:

2.1. çfarëdo kontrate publike:

(iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme, të cilat nuk kanë pasur mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj, me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta, ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.”*

Procedura e negociuar është zhvilluar në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LPP-së, duke përfshirë edhe dispozitat e lartcekura. Po ashtu, përmes nenit 50.8 të RRPP-së është përcaktuar si vijon:

“Kur autoriteti kontraktues vendos që t'i zhvillojë negociatat me një apo më shumë se një operator ekonomik, negociatat do të zhvillohen sipas dispozitave të neneve 49.15–49.19 të kësaj rregulloreje. Autoriteti kontraktues duhet të sigurohet që të negociojë me një numër të mjaftueshëm OE-sh për të siguruar konkurrencë efektive, si dhe të sigurohet që procesi është transparent dhe se të gjitha fazat e negociimit dokumentohen saktë për të mbrojtur integritetin e procesit.”

Fakti nëse parashtruesi është ftuar apo jo për ofertim nuk përbën shkelje ligjore, sikurse është pretenduar nga parashtruesi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1263, ndërsa me datë 10.01.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1263, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues,

shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE AGRI BAU SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1263 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr 1 .

OE ankues përmes ankesës se parashtruar thekson se AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të disa neneve përkatëse të LPP-se duke mos dërguar ftesën për ofertim operatorit ekonomik ankues dhe në këtë mënyrë AK-KK Prishtinë ka bërë shkelje të neneve përkatëse të LPP-se si në vijim:

Neni 4.1.2.26 Pale Interesi

Neni 7 Barazua në Trajtim

Neni 35 Procedura e Negociuar

Neni 50.8 Procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, i RROUP-se, etj.

AK-Komuna e Prishtinës me datë 08.12.2025 ka bërë Njoftimin mbi përdorimin e procedurës së negociuar sipas formularit standard të nxjerr nga KRPP. Njoftimi i dërguar në KRPP ka të bëjë me përdorimin e procedurës së negociuar të prokurimit pa publikim të njoftimit për kontratë sipas nenit 35.2.1 (iii) të Ligjit për prokurim publik për aktivitetin e prokurimit: Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit me nr prokurimi 616-25-11111-2-2-5, me shpjegimin si në vijim:

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit ka pasuar aktivitetin e prokurimit –ritender ku AK-Komuna e Prishtinës me datë 17.10.2025 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë përmes procedurës së hapur me nr prokurimi 616-25-9661-2-1-1. Pas një procesi të vlerësimit të tenderëve AK-Komuna e Prishtinës me datë 27.11.2025 ka nxjerr Njoftimin mbi Vendimin e AK-së ku është shpërblyer me kontratë GOE Agri Bau shpk dhe ANEA Group shpk, shih vendimi në vijim:

AK-Komuna e Prishtinës me datë 03.12.2025 ka nxjerr Vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtim të bërë nga OE Te Fatosi shpk, ku kërkesa për rishqyrtim aprovohet pjesërisht e bazuar dhe lënda kthehet në RI-Vlerësim.

AK-Komuna e Prishtinës me datë 11.12.2025 ka ngritur në E-prokurim Njoftimin mbi Vendimin e AK-së ku pas rivlerësimit ka shpërblyer me kontratë OE FATOSI shpk, shih vendimin në vijim:

Nga vendimet e mësipërme rezulton se AK-Komuna e Prishtinës pas procesit të rivlerësimit ka ndryshuar OE të rekomanduar për kontratë duke shpallur si të pa përgjegjshëm OE AGRI BAU shpk.

Pjesa e trajtuar më sipër nuk është objekt i ankesës sonë mirëpo është një ndërlidhje e procesit të aktivitetit të prokurimit për të cilën ne do të trajtojmë ankesën dhe pretendimet ankimore të OE ankues të bërë përmes ankesës në 2025/1263.

AK-Komuna e Prishtinës pasi që aktiviteti i prokurimit nr 616-25-9661-2-1-1 dhe titulli: Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit nuk ka rezultuar me kontratë me datë 08.12.2025 përmes Njoftimit mbi përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka

iniciuar aktivitetet e re te prokurimit sipas nenit 35.2.1 (iii) te Ligjit per Prokurim Publik.

- Me datë 10.12.2025 AK-Komuna e Prishtines ka dërguar letrën Standarde te Fteses për ofertim tek te tre operator ekonomik , shih pamjen ne vijim, mirëpo nuk është dërguar ftesa per ofertim edhe tek OE ankues Agribau shpk.

OE ankues me datë 17.12.2025 ka dërguar tek AK-KK Prishtinë kërkesën per rishqyrtim me pretendimin ankimor se si palë me interes jemi përjashtuar nga aktiviteti i prokurimit duke mos pranuar ftesën per ofertim.

AK-Komuna e Prishtinës me datë 18.12.2025 ka nxjerr Vendimin ndaj kërkesës per rishqyrtim ku hedhet e pa lejuar kërkesa per rishqyrtim e operatorit ekonomik AGRIBAU SHPK me arsetetimin se parashtruesi i kërkesës per rishqyrtim nuk është palë e inetersuar në kuptim te nenit 4 paragrafi 1, nenparagrafi 26 te LPP ku përcaktohet se “Palë e ineteresuar është personi qe mund te deshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit te prokurimit te zbatuar nga autoriteti kontraktus ne raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund te jetë ne rrezik te dëmtimit nga nje shkelje e pretenduar”.

Po ashtu AK-Komuna e Prishtinës pretendon se Procedura e negociuar është zbvilluar ne përputhje te plotë me dispozitat ligjore te LPP-së.

- Eksperti shqyrtues sqaron se procedura e negociuar pa publikim te njoftimit per kontratë duhet te zhvillohet ne harmoni te plotë me nenin 35 te LPP-se dhe nenin 50 te Rr. PP nr 001/2022 , plotësim ndryshim përmes Rr. PP nr 002/2024.

Konstatojm se AK-Komuna e Prishtinës ne rastin përkatës nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 50.6 te Rr. PP nr 001/2022 , plotësim ndryshim perms Rr, PP nr 002/2024, i cili thotë, citat paragarfi “Pjesëmarrësit në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duhet të përzgjedhen në mesin e Operatorëve ekonomik të përshtatshëm si dhe duhet të ftohen për të marrë pjesë nga ana e autoritetit kontraktues duke mos pasur për qëllim diskriminimin kundër apo në të mirë të ndonjë Operatori ekonomik”.

Po ashtu sipas nenit 50.8 te kesaj rregullore Autoriteti Kontraktues duhet të sigurohet që të negociojë me një numër të mjaftueshëm OE-sh për të siguruar konkurrencë efektive, si dhe të sigurohet që procesi është transparent dhe se të gjitha fazat e negocijimit dokumentohen saktë për të mbrojtur integritetin e procesit.

Nga këto dy paragrafë te neneve te mësipërme mendojm qe AK-Komuna e Prishtines nuk ka zbatuar këto dy nene sepse nuk ka dërguar ftesën per ofertim (Letren Standarde te ftesës per negocim) OE AGRIBAU shpk , i cili operator ekonomik ka qenë pjesë e ofertimit per aktivitetin e njejtë te prokurimit përmes procedures se hapur dhe madje ka qenë edhe i rekomanduar për dhënie kontrate mirëpo nuk ka rezultuar me kontratë per shkak te kërkesës per rishqyrtim te pranuar nga operator tjetër.

Nga procerverbali i hapjes i datës 12.11.2025 rezulton se OE ankues ne ofertimin ne procedurën e hapur me nr prokurimi 616-25-9661-2-2-1 ka pasur çmim me te lirë se OE i rekomanduar per kontratë andaj mos ftesa ne procedurën e negociuar është ne kundërshtim me piken b te nenit 50.7 te Rr.PP i cilit thotë: se Autoriteti kontraktues duhet të siguroj se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se sa çmimi i tregut në fjalë.

Andaj veprimet e AK-Komuna e Prishtinës saktësisht te zyrës se prokurimit duke mos dërguar ftesën për ofertim një operatori ekonomik i cili ka qenë pjesë e një procedure të tillë duke marrë pjesë në ofertim për të njëjtin qellim mendojmë që është shkelje e nenit 1 të LPP-se, nenit 6, nenit 7, nenit 35 të LPP-se dhe po ashtu nenit 50 të Rr. PP nr 001/2022.

Eksperti shqyrtues vlerëson se mos përfshirja e Operatorit Ekonomik ankues, është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht nenin 7, përbën diskriminim dhe trajtim jo të barabartë ndaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

AK, gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk i ka trajtuar të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, konkretisht OE ankues në mënyrë të barabartë sipas paragrafit 2 të nenit 7, ku thuhet: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik dhe po ashtu ky nen thekson se gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit, (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik, andaj në këtë rast kemi të bëjë me diskriminim të Operatorit Ekonomik ankues.

AK-Komuna e Prishtinës duke e trajtuar operatorin ekonomik si palë e pa interesuar në vendimin e nxjerrë si përgjigje në kërkesën për rishqyrtim mendojmë që ka bërë keqintërpjetim të nenit 4.1.26 të LPP-se i cili thotë, citat neni “Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”.

Në bazë të shkresave të lëndës dhe në përgjithësi bazuar në ecurin e ngjarjeve të cilat i kanë paraprijë procedurës së negociuar mendojmë që OE ankues në këtë rast ka qenë palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit sepse njëjtë si operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ashtu edhe OE ankues kanë qenë pjesëmarrës në aktivitetin e njëjtë të prokurimit që AK, ka zhvilluar me herët përmes procedurës së hapur andaj edhe këtu lind pyetja se pse OE i rekomanduar për kontratë është ftuar në procedurën e negociuar (ju është dërguar letra e ftesës për negociim) ndërsa OE ankues nuk ka pranuar ftesën për negociim në procedurën e negociuar dhe në këtë rast kemi të bëjmë me trajtim të pa barabart në mes të operatoreve ekonomik të cilët me herët kanë shfaqur interes për këtë aktivitet të prokurimit.

Sqarojmë faktin se “palën e interesuar” në një aktivitet të prokurimit nuk e përcakton Autoriteti Kontraktues por rrethanat në të cilat është zhvilluar aktiviteti i prokurimit dhe shprehja e interesit të operatoreve ekonomik për aktivitetin e prokurimit që në rastin e tillë duke u bazuar në tërë ecurin e mësipërme të ngjarjes mendojmë që OE ankues ka qenë palë e interesuar në këtë aktivitet të prokurimit sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

- Në kuadër të pretendimit ankimor nr 1 OE ankues pretendon se përkundër kërkesës përmes email-ave dhe kërkesës me datë 18.12.2025 përmes E-prokurimit AK – Komuna e Prishtinës nuk ka kthyer ndonjë përgjigje në lejmimin e qasjes në dokumentet e tenderit sipas nenit 10 të Ligjit për Prokurim Publik –Mjetet mbi Promovimin e Transparencës.

Kjo perben shkelje te nenit 10 te LPP-se respektivisht nenit 10.3 i cili thote: Me kerkesen me shkrim nga cilado pale e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje te arsyeshme pale qe kerkon te ketë qasje ne të dhënat e pershkruara ne paragrafin 1 dhe 2 te ketij neni, pervec informatave sekrete afariste te cilat vertetohen si te tilla nga një autoritet perkatës qe kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit qe është mbyllur.

Bazuar ne pershkrimin e mesiperm konstatojm se pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara qe të sigurojnë qe fondet publike dhe burimet publike te perdoren ne menyren me ekonomike ashtu siç parashihet ne nenin 6 te LPP-së, njekohesisht duke marr ne konsiderate qellimin dhe lendën e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet te ketë ne konsiderate edhe nenin 1 dhe 7 te LPP-se pasi qe dihet se qellimi i ketij ligji është te siguroj menyren me efikas, me transparent dhe me të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Bazuar ne pershkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore te operatorit ekonomik ankues, ecurin e aktiviteve te meherhme te prokurimit qe kanë dërguar deri te përdorimi i procedurës se negociuar dhe ne tërësi ne bazë te pershkrimit dhe sqarimeve te lartcekura mendojm qe aktiviteti i prokurimit benë pjesë ne Prokurimet e Mbyllura ne Kundërshtim me ligjin per prokurim publik-neni 132, andaj rekomandojm Panellin Shqyrtues qe ankesa e operatorit ekonomik ankues te aprovohet si e bazuar dhe panelli shqyrtues te veproj sipas dispozitave ligjore te nenit 132 dhe 133 te LPP-së dhe kompetencave te OSHP-së.

Rekomandimin e mbështesim duke u bazuar ne tërësi ne rrjedhën e aktivitetit te prokurimit duke pas parasysh faktin se AK, me datë 16.12.2025 ka bërë edhe njoftimin per nënshkrim te kontratës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, pergjigjeve të dhëna nga eksperti i chështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenesore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti qe ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e pergjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto pergjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit ku sipas sistemit të e-prokurimiti AK ka inicuar procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës sikurse parashihet ne nenin 35 2.1 (iii) të LPP-së nevojë ekstreme emergjente ku sipas dates 08.12.2025 AK ka njoftuar Komisionin Rregullativ

për Prokurimin Publik sipas srsyetimit ku në procedur të hapur kemi një kërkes për rishqyrtim dhe AK ka kthyer lëndën në ri-vlerësim dhe se Kryeqyteti ka mbetur pa dekorim për festat e fundëvitit për çka edhe është inicuar kjo procedur. Sipas të dhënave dosja e tenderit (ftesa për ofertim) e datën 10.12.2025 i'u është dërguar 03 OE, mirpo jo edhe ankuesit sikurse ankuesi ka paraqitur ankesë pran OSHP-së për mos dorëzimin e ftesës për ofertim nga AK-ja.

Paneli Shqyrtues analizoj edhe raportin ekspertit shqyrtues rekomandimin ku citohet “ *eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar*. Mirpo PSH nuk e mbështet raportin e ekspertizes, ngase nuk ka ofruar asnjë rekomandim, poashtu Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh situatën e krijuar ku AK-ja ka inicuar proceduren në munges të kontratës, dhe ka arsyetuar iniciimin e kësaj procedure sikurse parashihet në nenin 35.2 (iii) të LPP-së, dhe në platformën e e-prokurimit për këtë procedurë Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik nuk ka ofruar asnjë rekomandim apo opinion sikurse parashihet në nenin 86, 87 dhe 91 të Ligjit të Prokurimit Publik, Paneli Shqyrtues sipas autorizimit të dates 23.01.2026 , mare parasysh se kanë kaluar festat e fundvitit ka vendosur që ankesen e OE ankues ta aprovoj si pjesërishtë të bazuar, lidhur me aktiviteti i prokurimit me titull; “Dekorimi i kryeqytetit për festat e fund vitit-Negociuar me numër të prokurimit 616-25-11111-2-2-5, dhe kontrata të mbetet në fuqi.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike. Poashtu duke mare parasysh edhe nenin 7 të LPP-se

Poashtu Panei Shqyrtues vlereson sikurse parashihet ne nenin Neni 24 i LPP-së citoj 2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: